



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 7 SHTATOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 7. SEPTEMBRA 2012. GODINE**

**SHTATOR - SEPTEMBAR
2012**

Rendi i ditës

1. Miratimi i amendamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, të propozuara nga Qeveria.
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë

Dnevni red

1. Usvajanje amandmana na Ustav Republike Kosova koji se odnose na okončanju međunarodnog nadgledanja nezavisnosti Kosova, predloženih od Vlade.
2. Razmatranje Nacrt zakona o ratifikaciji Međunarodnog sporazuma između Republike Kosova i Evropske zajednice o Evropskoj misiji za vladavinu zakona na Kosovu.

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar mysafirë,

Mirë se keni ardhur në mbledhjen plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, dhe të plotësuar edhe me një pikë të rendit të ditës.

- Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë

Do të thotë i kemi dy pika të rendit të ditës.

Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, një votim për praninë me elektronikë.

Të pranishëm janë 98 deputetë, kurse me kartela i kemi të pranishëm 104 deputetë. 6 po na mungojnë. Lus regjinë le ta printojë praninë e deputetëve.

Domethënë tash 103 janë të pranishëm, ndërkaq praninë e kanë treguar 93. deputetë, kurse me kartela janë 105 momentalisht.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Miratimi i amendamenteve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, të propozuara nga Qeveria

Në pajtim me nenin 144, paragrafi 1 i Kushtetutës, Qeveria e Kosovës ka propozuar amendamentimin e Kushtetutës që ka të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Këto amendamente kryetari i Kuvendit ia ka adresuar Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar nëse të njëjtat e pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Komisioni ad hoc për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës i ka shqyrtuar amendamentet kushtetuese që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Kosovës, si dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që ta marrë fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryetar, I nderuar kryeministër, anëtarë të Qeverisë, Të nderuar deputetë, Ndoshta për hir të rregullshmërisë të asaj që të mos krijohet vakum juridik për funksionimin e EULEX-it në Kosovë, fillimisht duhet të miratohet Ligji për ratifikimin e marrëveshjes, pastaj amendamentimi i Kushtetutës. Ju propozoj një mirëkuptim.

KRYETARI: I nderuar zëvendëskryeministër, ta kam dhënë fjalën për ta arsyetuar pikën e parë të rendit të ditës. Arsyetoheni pikën e parë të rendit të ditës, pastaj vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Okej, faleminderit zoti kryetar! Unë nuk e pata për ndonjë qëllim tjetër, po duhet ta pranojmë një fakt juridik. Ndryshimet kushtetuese hyjnë në fuqi në momentin e votimit në Kuvend, do të thotë nuk ka asnjë minutë më tutje. Ndërsa letra që ka të bëjë me mandatin e EULEX-sit krijon vakum juridik. Ky është problemi kryesor. Përndryshe, unë jam i gatshëm ta prezantoj cilindo që merremi vesh ju.

Faleminderit, zoti kryetar, unë dua të besoj që me amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës sot po e shënojmë një hap përfundimtar në përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës dhe jam i nderuar që në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës t'i prezantoj amendamentet e propozuara nga Qeveria e Kosovës, të cilat më pastaj kanë marrë pëlqimin nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës dhe mbështetje nga Komisioni për Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për çka dua të shpreh falënderim të veçantë.

Më lejoni të them që në bazë të nenit 93.9 dhe nenit 144.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe duke marrë parasysh Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, e miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 31 janar të këtij viti, dhe në pajtim me nenin 16, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë, të muajit IX të vitit 2011, ne i kemi propozuar për miratim këto amendamente.

Natyrisht, 22 amendamente të propozuara, me përjashtim të amendamentit 17, i cili kalon në kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që nënkupton që të drejtat e refugjatëve të rregullohen sipas parimeve për liri dhe të drejtat e njeriut, çështjet e tjera janë të miratuara. Dhe, sot mund të them me krenari që ky përfundim ka ardhur si rezultat i një pjekurie të institucioneve të vendit tonë, një pjekurie të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe një mirëkuptimi për vlerësim pozitiv të bashkësisë ndërkombëtare.

Natyrisht, ne presim që nga sot të rritet përgjegjësia e institucioneve vendore dhe funksionimi si shtet sovran i pavarur me plotëni në kuptimin e gjithë asaj sikur hapërojnë edhe kombet e lira. Ju ftoj për miratimin e këtyre amendamenteve.

KRYETARI: Faleminderit zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë! Fjalën tani e ka kryetari i Komisionit ad hoc për amendamentimet kushtetuese, zoti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: I nderuari kryetar i Kuvendit,
I nderuari kryeministër, ministra,
Kolegë deputetë,

Pa dyshim që 7 shtatori është një moment historik për Kosovën, një proces i filluar para 22 vjetëve me miratimin e Kushtetutës së Kaçanikut, sot po përmbyllet me fitimin e pavarësisë së plotë për Republikën e Kosovës dhe pa dyshim se ky është një moment falënderimi për të gjithë ata që kontribuan që Kosova sot të jetë shtet sovran dhe i pavarur dhe pa mbikëqyrje ndërkombëtare. Në radhë të parë, falënderimi shkon për të gjitha partitë politike, për gjithë anëtarët e Komisionit Kushtetues, që kanë treguar një unitet në proceset shtet-krijuese. Por, më lejoni t'i falënderoj në emër të Komisionit Kushtetues edhe gjithë partnerët ndërkombëtarë, të cilët e kanë ndihmuar këtë proces dhe ne kemi krijuar një unitet të plotë në Komision me rastin e shqyrtimit dhe miratimit të këtyre 22 amendamenteve.

Komisioni i ka shqyrtuar në mënyrë të detajuar këto amendamente të ardhura formalisht nga Qeveria si propozues i autorizuar dhe njëzëri i ka propozuar Kuvendit që ato t'i miratojë, sepse me këto amendamente, në fakt, fuqizohet komplet dispozitat e tranzicionit, dispozitat që ne edhe kur e kemi shkruar Kushtetutën me qëllimi i kemi lënë në fund, sepse e kemi ditur që do të vijë dita që komplet kjo kaptinë e dispozitave tranzicionale të fuqizohet dhe Kosova nuk do të ketë mbikëqyrje ndërkombëtare.

Shumica e amendamenteve, nga këto 22, janë amendamente me të cilat shfuqizohet prania civile ndërkombëtare dhe në fakt autoritetet qeverisëse kalojnë tek institucionet e Kosovës.

Vetëm te një amendament e kemi pasur një opinion të Gjykatës Kushtetuese, një konstatim se ky amendament e zvogëlon sfondin e lirive dhe të drejtave të njeriut, prandaj Komisioni ka propozuar që ky amendament të spostohet nga neni 156 në kaptinën për liritë dhe të drejtat e njeriut. Pra, bëhet fjalë për të drejtat e përhershme të kthimit të refugjatëve dhe ne rekomandojmë që të pranohet ky rekomandim i Komisionit, që ky amendament të spostohet në këtë pjesë të Kushtetutës.

Gjithashtu ju përkujtoj se amendamentet në bazë të Kushtetutës hyjnë në fuqi në momentin e miratimit dhe me miratimin e amendamenteve ne po e fuqizojmë edhe Ligjin për përmbylljen e mbikëqyrjes përfundimtare, apo legjislacionin primar, që e kemi miratuar kohë më parë dhe me këtë në aspektin kushtetues dhe legal po përmbyllet procesi i mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

Edhe një herë, falënderoj të gjithë aktorët dhe partnerët e këtij procesi dhe lus deputetët që ta mbështetin rekomandimin e Komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, kryetari Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!
Zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, për shkak të rëndësisë së veçantë që ka vlerësuar që do ta ketë ky moment, në vazhdimësi e ka përcjellë punën e Komisionit nëpërmjet përfaqësuesit tonë. Kemi shqyrtuar në vazhdimësi dhe kemi dhënë vërejtjet dhe sugjerimet tona nëpërmjet përfaqësuesit tonë dhe kemi mbajtur po ashtu takime, në kohën e fundit, ku e kemi analizuar gjithë procedurën në tërësi dhe i kemi dhënë mbështetje pa rezervë aprovimit të këtyre amendamenteve. Prandaj, sot u bëjmë thirrje edhe kolegëve të tjerë që vërtet t'i mbështetim dhe sot të dalim të bashkuar si gjithnjë kur kanë qenë në pyetje interesat kombëtare.

Prandaj, i ftoj të gjithë t'i aprovojme këto amendamente. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kryetari Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht e shfrytëzoj rastin që të ju uroj të gjithëve juve këtu dhe qytetarëve të Kosovës 7 shtatorin, përkatësisht 22-vjetorin e shpalljes së Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e njohur si Kushtetuta e Kaçanikut. Falënderim dhe respekt për ata deputetë që i vunë themelet e shtetit të Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Lidhja Demokratike e Kosovës vlerëson se përfundimi i mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës është një fazë e rëndësishme në shtetndërtimin e vendit. LDK-ja e ka pasur dhe e ka një rol të pazëvendësueshëm në rrugëtimin e shtetformimit dhe shtetndërtimit të Kosovës.

Roli i LDK-së dhe presidentit historik Doktor Rugova në këtë proces është i rëndësishëm së veçantë, në procesin edhe të krijimit dhe të ndërtimit të raporteve dhe lidhjeve të ngushta me faktorët vendimmarrës ndërkombëtarë siç janë SHBA-të dhe shtetet e Bashkimit Evropian.

Sigurisht që roli politik institucional i LDK-së, lufta e drejtë e UÇK-së, sakrifica shumëvjeçare e qytetarëve të Kosovës dhe ndihma e faktorit ndërkombëtar mundësuan që sot Kosova të jetë shtet dhe gradualisht të marrë edhe kompetenca shtesë shtetërore.

LDK-ja është e vetëdijshme se Kosova ka probleme të mëdha, siç janë korrupsioni, mungesa e sundimit të ligjit, varfëria, moszhvillimi ekonomik dhe, mbi të gjitha, mosushtimi i sovranitetit shtetëror në tërë territorin e vendit, veçmas problemi i veriut, si dhe probleme të tjera. Andaj, nuk ka vend për festime të mëdha. Festën dua ta shndërrojmë në punë, përgjegjshmëri, në kryerjen e obligimeve shtetërore, veçmas Qeveria e Kosovës në ruajtjen e tërësisë territoriale të vendit.

Ne kemi qenë dhe mbetemi subjekt politik i përgjegjshëm dhe institucional, nuk kemi qenë dhe as nuk do të jemi pengesë në proceset pozitive në interes të vendit.

LDK-ja asnjëherë nuk e ka lidhur këtë proces të përmbylljes së mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë me marrëveshjes e arritur vitin e kaluar ndërmjet liderëve dhe me Rezolutën e Kuvendit, të miratuar më 7 prill të vitit të kaluar.

Edhe sot ua bëjmë me dije të gjithëve se ne vazhdojmë dhe insistojmë që këto dy dokumente të respektohen dhe të implementohen.

Ka pasur dhe ka tendenca se nuk po e respektojmë marrëveshjen dhe Rezolutën, thuhet kësisoj, për të krijuar huti në opinion.

LDK-ja nuk është bllokuese e asnjë procesi. LDK-ja sot do të votojë për amendamentet kushtetuese, që i kemi në rend të dite, me qëllim të përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

Ne jemi shumë të vetëdijshëm se në Kosovë ende do të kemi prani ndërkombëtare, veçmas të dy mekanizmave të rëndësishëm, siç është ai i sigurisë dhe i sundimit të ligjit, pra KFOR-i dhe EULEX-i.

Të nderuar kolegë deputetë,

Fare në fund, LDK-ja dhe lideri zoti Mustafa, në kontakte të vazhdueshme dhe bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar, veçmas me përfaqësuesit e QUINT-it, do ta vazhdojë edhe më tej kontributin e saj në të mirën e vendit.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës do t'i mbështesë dhe do t'i votojë këto amendamente kushtetuese, të propozuara sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Është një seancë goxha e rëndësishme në të cilën jemi sot, kur do t'i diskutojmë disa amendamente kushtetuese, të cilat pritet nga ne edhe t'i votojmë. Pra, është një seancë, për të cilën në fjalimet e deritashme e dëgjova një tendencë për të qenë një seancë festive, pra një seancë ku të gjithë dakordohemi, të gjithë rrahim shuplaka në fund dhe gëzohemi për këto amendamente kushtetuese.

Por, megjithatë, unë do t'i ngre disa çështje që kanë të bëjnë me Kushtetutën, të cilat nuk po amendamentohen në këtë rast, pra me të cilat po e humbim një shans për ta bërë këtë vërtet Kushtetutë sovranë të Republikës së Kosovës dhe vërtet të një Kosove me shumicë dërmuese të shqiptarëve.

Kjo Kushtetutë i ka pasur disa probleme themelore, një pjesë e konsiderueshme e të cilave po mbeten edhe pas këtij amendamentimi.

Për shembull, problemi kryesor që ka qenë, ose i pari, të them ashtu, është mohimi i identitetit tonë kombëtar. Kjo Kushtetutë, as në preambulën e vet, e as në tekstin e saj, askund nuk e afirmon shumicën shqiptare të Kosovës, pra askund nuk e vlerëson Kosovën si një shtet me shumicë shqiptare. Shqiptarët, 95% të popullsisë së përgjithshme të Kosovës, vendosen në nivelin e njëjtë juridik dhe politik me të gjitha bashkësitë tjera që quhen këtu kombëtare, pra barazohen me 5% serbë, 3% boshnjakë, me turq e të tjerë. Pra, nuk është Kushtetutë e cila ua njeh të drejtat pakicave, por është kushtetutë e cila e nënvendos shumicën në pozitë të pakicave, duke i bërë të gjitha bashkësi kombëtare, me të drejta të garantuara si bashkësi kombëtare.

Ndërkohë, me ato që u referuan në dy prej fjalimeve, pra në Kushtetutën e Kaçanikut, për të cilën edhe unë i përgëzoj qytetarët, meqenëse është data 7 shtatori, pra përvjetori i saj, kjo çështje rregullohet shumë më ndryshe. Pra, nëse nuk e keni lexuar këtë tekst, sepse u bënë 22 vjet, atëherë vetëm po jua përmendi nenin 1. Neni 1 i asaj kushtetute ka thënë kështu: “Republika e Kosovës është shtet demokratik i kombit shqiptar dhe i pjesëtarëve të kombeve të tjera dhe i pakicave kombëtare të shtetasve të vet, të serbëve, myslimanëve, malazezve, kroatëve, turqve, romëve e të tjerëve, që jetojnë në Kosovë”. Pra, ka qenë Kushtetutë që i ka mbrojtur të drejtat e pakicave, ka qenë në Kushtetutë që e ka pranuar praninë e pakicave kombëtare në territorin e Kosovës, mirëpo ka qenë Kushtetutë, e cila është bazuar në vullnetin politik të shumicës dërmuese të qytetarëve. Ndërkohë që kjo e jona tash, të cilën po e amendamentojmë, i mohon këto, nuk bazohet në këtë vullnet.

Çështja tjetër: Kjo Kushtetutë deri tash ka qenë mohim i drejtpërdrejtë edhe i demokracisë, edhe i fuqisë ekzekutive, për shkak se përbrenda saj kanë qenë nenet, të cilat ua kanë garantuar pushtetin absolut ekzekutiv misioneve ndërkombëtare. Jo institucioneve të Kosovës, por misioneve ndërkombëtare. Tash po thuhet që u përmbyll ky proces. Pra, tash e tutje do t’i kemi të gjitha kompetencat ekzekutive përmbi çdo aspekt të jetës shoqërore politike, juridike në Kosovë. Po, a është vërtet kështu? Se ne sot, me këtë përmbyllje që po ia bëjmë procesit të mbikëqyrjes së pavarësisë dhe me këtë amendamentim të Kushtetutës po i heqim ato nene ku përmendet përfaqësuesi civil ndërkombëtar.

Ndërkohë, në pikën 2 do t’ia vazhdojmë pushtetin ekzekutiv në aspekte shumë të rëndësishme të sovranitetit të shtetit EULEX-it, i cili është mision ndërkombëtar, që është i pranishëm në Kosovë, i cili nuk u jep llogari institucioneve të Kosovës, i cili nuk është i zgjedhur prej qytetarëve të Kosovës dhe, në ndërkohë, i cili ka pushtet ekzekutiv, por edhe imunitet nga ligji.

Pra, ky është një aspekt, ku ne nuk po e përmbylim mbikëqyrjen e pavarësisë, mirëpo po e ngremë atë, siç do të kërkohet në pikën 2, nëpërmjet një ligji si ratifikim për marrëveshjen ndërkombëtare, në kategorinë apo në nivelin e fuqisë së votës, që e ka Kushtetuta, pra me 2/3-at e votës.

Kjo nënkupton që në fakt mbikëqyrja përmbi institucionet e Kosovës nuk po përfundon, vetëm po ndryshon në formë. Këtë, Kushtetuta e Kaçanikut nuk e ka pasur.

Tjetër? Kjo Kushtetutë është mohim i sovranitetit dhe i integritetit territorial, për shkak se në njërën anë u garanton sipërvendosje të fuqisë së votës bashkësive të caktuara etnike, pra në dëm të shumicës, duke e bërë votën e qytetarit shqiptar të Kosovës më të pavlefshme se sa votën e një qytetari tjetër, të një përkatësie tjetër kombëtare. Ndërkohë që është Kushtetutë, e cila kur ka hyrë në fuqi, vetëm e ka shuar TMK-në dhe e ka krijuar një Forcë të Sigurisë së Kosovës, pra pa e bërë atë ushtri.

Dhe, tash, në këtë moment, që Qeveria dhe të tjerët po e quajnë historik, ne nuk po e bëjmë një hap tjetër historik për ta shpallur FSK-në ushtri të Kosovës. E garantim të sovranitetit dhe integritetit territorial pa ushtri vështirë se mund të ketë.

Ndërkohë që nuk po bëjmë asgjë po ashtu për ta rivlerësuar procesin e decentralizimit dhe kompetencave shtesë për disa komuna të caktuara të Kosovës, të cilat, përveçse e përcudnojnë funksionalizimin e brendshëm të Kosovës, po ashtu e përcudnojnë edhe atë që quhet integritet territorial dhe sovranitet përmbi krejt territorin. Pra, nuk mund të thuhet se e kemi në Kosovë, për shkak se në komunat, që quhen me shumicë serbe, policia, thuhet në Kushtetutë dhe në Planin e Ahtisarit, domosdoshmërisht duhet të jetë serbe, Gjyqësia domosdoshmërisht duhet të jetë serbe. Pra, po ndërtohet një polici serbe dhe një gjyqësi serbe, në një Kosovë ku ekziston një polici dhe një gjyqësi.

Kjo është në kundërshtim me parimin e sovranitetit dhe në kundërshtim me parimin e barazisë ndërmjet qytetarëve.

Tjetër? Kjo Kushtetutë e ka mohuar Gjyqësorin e pavarur. Në çfarë aspekti? Kushtetuta thotë që gjykatat tona do të jenë të pavarura. Formalisht e deklaron këtë. Mirëpo, pastaj prania ndërkombëtare e ka një pushtet ekzekutiv përmbi gjykatat tona, madje-madje edhe në emërimin e gjykatësve të caktuar përbrenda sistemit tonë juridik. Pra, kjo nuk është pavarësi e Gjyqësorit për shkak se këto misione nuk mund të quhen të pavarura. Këto misione, misioni i EULEX-it është neutral karshi statusit të Kosovës, pra në njëfarë mënyre nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe, në ndërkohë, kjo nuk është pavarësi dhe neutralitet politik, për shkak se është në kundërshtim me atë që, në fakt, ky Kuvend e ka bërë në formën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Pra, nuk e njeh atë shpallje dhe këto misione nuk janë të pavarura nga politika. Ndoshta janë të pavarura nga politika partiake në Kosovë, por nuk janë të pavarura nga politika në përgjithësi, që është politikë e bashkësisë ndërkombëtare, në këtë rast politikë e Bashkimit Evropian përbrenda Kosovës.

Pra, ka ndikim politik në Gjyqësorin e Kosovës. Të mos e mohojmë këtë.

Tjetër? Kjo Kushtetutë, po ashtu e mohon barazinë para ligjit. Edhe pse formalisht deklaron se do t'i trajtojë të gjithë qytetarët barabar, në fakt nuk na konsideron si individë, por si bashkësi etnike. Dhe, në këtë drejtim, ajo, siç e thashë edhe më herët i

ndanë gjyqësinë dhe policinë në baza etnike, siç e ka ndarë territorin në komuna në baza etnike.

Tjetër? Kjo Kushtetutë e mohon demokracinë shoqërore. Pra, Kushtetuta thotë që Kosova do të jetë ekonomi e tregut të lirë me konkurrencë të hapur, mirëpo nuk i afirmon njëkohësisht edhe të drejtat e popullit për mirëqenie shoqërore dhe mbrojtje nga tregu, siç përcaktohet edhe me konventa ndërkombëtare për të drejta sociale.

Kushtetuta e Kaçanikut e ka pasur këtë të rregulluar ndryshe. Ja si e ka pasur: Organizimi i jetës ekonomike dhe sociale rregullohet në mënyrë që të gjithë qytetarëve t'u sigurojë standard të jetesës në pajtim me drejtësinë, të bazuar në punën e tërësishme, si burim i mirëqenies dhe në pajtim me dinjitetin njerëzor.

A po e vëreni ku është dallimi, që është thelbësor? Në Kushtetutën aktuale, që po e amendamentojmë, variabla... *(Ndërprerje)*... variabla..., pra ekonomia e tregut dhe qytetari shihen si mjet për ta përmbushur këtë parim. Ndërkohë, që në Kushtetutën e Kaçanikut variabla e padiskutueshme ka qenë qytetari. E tregu është parë si një mjet për t'ia përmbushur dhe rritur mirëqenien qytetarit, mirëpo jo për t'ia nënvendosur interesin e qytetarit një interesi, një parimi ideologjik që është tregu, që po e bën Kushtetuta dhe që e ka bërë në fakt Kushtetuta e Kosovës, të cilën nuk po e amendamentojmë sot, në këto aspekte të cilat i përmenda.

Pra, kur themi që po e përmbyllim mbikëqyrjen e pavarësisë, atëherë duhet vërtet ta përmbyllim mbikëqyrjen e pavarësisë, gjë që nuk po ndodh sot me këto amendamente kushtetuese. Ndërkohë, në këtë moment, që po quhet historik, ne po e humbim shansin historik që vërtet këtë Kushtetutë ta bëjmë Kushtetutë të qytetarëve të Kosovës dhe për qytetarët e Kosovës. Për shembull, nuk po flet kurrkush për nenin 1.3, që ia ndalon Kosovës të drejtën e ushtrimit të sovranitetit në aspektin e jashtëm. Është e drejtë sovrane e një shteti të përcaktohet nëse do të bashkohet me një shtet tjetër. Kushtetua jonë këtë na e ndalon!

Pra, kjo Kushtetutë e Kosovës, përgjithësisht, nuk ka qenë Kushtetutë që i sanksionon të drejtat e qytetarëve të Kosovës, por më shumë ka qenë Kushtetutë që sanksionon kushtëzime Kosovës si shtet. Dhe, këtyre kushtëzimeve, forma po u hiqet sot, mirëpo përmbajtja e tyre vetëm sa po sforcohet. Pra, në disa amendamente, të cilat do t'i votoni ju sot, ka sforcim të të këqijave, të cilat kanë qenë deri tash në Kushtetutën e Kosovës. E a to përmirësime, meqë ka përmirësime, nuk po e mohoj, karshi këtyre tjerave që po ndodhin, janë vetëm kozmetike.

Pra, nëse dikush pyet: A po e heqim Piter Fejtin? - Po e heqim Piter Fejtin. Nëse dikush pyet: A po e heqim mbikëqyrjen ndërkombëtare? - Në disa aspekte po e përforcojmë atë. Nëse dikush pyet: A po e garantojmë tash barazinë e qytetarëve? Unë mendoj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka kryetari i Grupit, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës mendon se populli i Kosovës, për më shumë se dy dekada prej Kushtetutës së Kaçanikut, e cila u përmend këtu, ka kaluar nëpër faza shumë të vështira, shumë të dhembshme, edhe të lavdishme. Dhe, populli i Kosovës e ka kuptuar këtë proces që ka zgjatur shumë dhe mendojmë se ndryshimet, të cilat besoj do t'i votojmë sot janë edhe një moment në këtë rrugë të gjatë të Kosovës, prej një robërie të thellë deri te një subjektivitet i ardhshëm ndërkombëtar i plotë.

Mendojmë se do të duhet shumë punë edhe në të ardhmen, që mundësia e cila hapet me përmbylljen e pavarësisë së mbikëqyrur të bëhet realitet dhe Kosova të jetë pjesë e bashkësisë ndërkombëtare, do të thotë bashkësisë së kombeve, sa më shpejt që të jetë e mundshme, me të gjitha atributet e shtetit sovran.

Ajo që ne mendojmë se po e bëjmë sot është që nga Kushtetuta e Kosovës po i heqim provizionet, të cilat në mënyrë kushtetuese e lidhin Kosovën me një mbikëqyrje. Ajo që e kemi bërë javën e kaluar është se i kemi hequr provizionet nëpër ligjet e Kosovës, të cilat e kanë bërë Kosovën të mbikëqyrur dhe mendojmë se nuk është diçka që duhet të nënvlerësohet.

Detyrimisht, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do t'i votojë ndryshimet kushtetuese për heqjen e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës dhe mendojmë se Kosova ka mësuar që të mos e fusë në luftë perfekten me të mirën, për shkak se nëse hyjnë në luftë perfektja me të mirën, nuk fitojnë asnjëra. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e grupit, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar! Përsëritet për Qeverinë, për deputetët dhe gjithë stafin ndërkombëtar, që është këtu prapa, duke e përcjellë këtë seancë!

Koalicioni për Kosovë të Re i përkrah amendamentet e propozuara për ndryshimin dhe plotësimin e Kushtetutës së Republikës për përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë, duke marrë parasysh se projektit të presidentit Rugova për një shtet me mbikëqyrje ndërkombëtare i erdhi fundi dhe falë luftëtarëve të lirisë, që sot ne i gëzojmë këto vende këtu, besoj që Qeveria, deputetët dhe gjithë qytetarët e Kosovës duhet ta dinë që sot vihet bazamenti i shtetit, apo më mirë të themi bazamenti i shtëpisë, ndërsa që të ndërtohet shtëpia duhet akoma punë.

Dhe, në këtë punë, Kuvendi së bashku me të gjitha partitë politike, si dhe Qeveria, besoj që do t'ia japim vendin e merituar, edhe Kosovës, edhe qytetarëve të saj.

Koalicioni për Kosovë të Re i përkrah këto amendamente dhe shpresoj që në të ardhmen do të punojmë së bashku për shtetin tonë.

KRYTARI: Në emër të SLS-së, kryetari i grupit, Sasha Milosavleviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Poštovani predsedniče Skupštine,

Uvaženi članovi Vlade,

Kolege poslanici,

Uvažavajući ozbiljnost posla koji danas obavljame i naših poslaničkih zadataka, Parlamentarna grupa SLS-a i danas, kao i ranije, ponašaće se odgovorno.

Iako nismo u potpunosti zadovoljni svim rešenjima koje proizilaze iz ustavnih amandmana, mi ćemo danas pokazati da želimo dobro svim građanima Kosova i da ustupci, koje danas činimo proizilaze iz čvrstih garancija predstavnika međunarodne zajednice da će nas podržati u naporima da zaštitimo interese i prava naših zajednica.

Posebno zabrinjava činjenica da je predsednik ad hoc Komisije za izmenu Ustava u medijskim nastupima izneo niz neistinitih navoda. Sa ovog mesta želim da demantujem da predstavnici manjinskih zajednica, prvenstveno srpske, nisu podnosili predloge amandmana za izmenu Ustava. U više navrata, u usmenom i pismenom obliku, obraćali smo se komisiji sa konkretnim predlozima.

Takođe, nekorektna je izjava kolege Bajramija da srpska zajednica insistiranjem na svojim interesima traži previše.

Želimo da obavestimo poslanike i Kosovsku javnost da naša odgovornost prema političkom procesu ne može biti zloupotrebljena, i da nećemo dozvoliti da neodgovorno ponašanje pojedinaca doprinese utisku da je neko danas uspeo da nas prevari.

Naprotiv, vrlo svesno i u saradnji sa svim relevantnim predstavnicima međunarodne zajednice, doneli smo odluku da danas glasamo za Ustavne amandmane. To ne znači da ćemo odustati od naših legitimnih interesa, već da ćemo se za njih zalagati još snažnije i odlučnije.

Podsećamo Vas uvažene koleginice i kolege, da ovo nije kraj Ustavnih i izborni reformi, i da će i u nardnom periodu naša podrška biti neophodna.

Nije prvi put da mi, predstavnici srpske zajednice u Skupštini Kosova, da podignemo ruku za određena rešenja i hrabro preuzmemo odgovornost za odluke, zbog kojih smo bili meta demagoga i kuazipatriota.

Neodgovorno ponašanje pojedinaca može uticati na poslanike SLS-a da prestanu da na principielan i dostojan način brane interese srba na Kosovu, iako nas često jevtina demagogija udaljava iz političkog procesa.

Podsećamo da je današnje glasanje za Ustavne amandmane deo političkog procesa i dogovora u kome smo mi jasno izneli svoje stavove i interese u vezi zastupljenosti srpske zajednice u institucijama Kosova. Na tome ćemo nastaviti da insistiramo. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit „6+“, fjalën e ka deputeti Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Poštovani predsedniče Skupštine,
Poštovani premijeru,
Poštovani poslanici,
Danas je jedan od najznačajnijih dana u istoriji Republike Kosova, dan kada nezavisnost Kosova dobija potpunu samostalnost, bez nadgledanja.

Mi kao Parlamentarna Grupa „6+“, koja je sačinjena od tri zajednice: bošnjačka, turska i romska, uvek smo kao predstavnici svojih zajednica bili za zaštitu svojih prava i napretka Republike Kosova u svim procesima.

Svesni smo činjenice da naš glas za ustavne promene ima veliki značaj u političkom smislu i gde možemo svojim glasovima blokirati proces Ustavnih promena.

Naš zahtev za produžetak rezervisanih mesta, nažalost od strane komisije nikada nije razmatran. Istu temu smo više puta govorili u više navratima. Danas, kao Parlamentarna Grupa „6+“ veoma smo razočarani sa izjavama predsednika Komisije za ustavne promene, uvaženog profesora Arsim Bajramija, koji izjavljuje da se nikada nismo obratili komisiji sa konkretnim zahtevima.

Čast nam je da danas ispred Parlamenta Republike Kosova, ispred naših zajednica koje predstavljamo, ispred medijima, da pokažemo naš zahtev, koji smo više puta dostavili komisiji, a koji nikada nije bio razmatran.

Ovo smo dostavili arhivi, o ovome znaju svi, međutim ono što smo danas čuli, odnosno juče, u izjavama koje je dao predsednik komisije, mi kao Parlamentarna Grupa „6+“ razmotrićemo da li ćemo učestvovati u daljoj komisiji, dok uvaženi profesor gospodin Arsim Bajrami ne povuče lažne izjave koje je dao pred medijima.

Ja koristim priliku da se zahvalim i svima onima koji su nam dali veliku podršku. Posebnu zahvalnost, znači izražavam ambasadorima QUINT-a, to jest Sjedinjenim Američkim Državama, Velike Britanije, Italije, Francuske, Nemačke i ambasadorke Republike Turske, i svima onima koji nas podržavaju u ovim velikim naporima.

Mi ćemo danas, zbog ozbiljnosti situacije, zbog daljeg napretka Republike Kosova, biti konstruktivni i tražimo od poslanika, od ovog uvaženog Parlamenta, da i oni budu konstruktivni kada su u pitanju naši zahtevi. Hvala puno!

KRYETARI: Kryetarët e grupeve parlamentare i dëgjuat. Ju lutem, debat nuk ka. Kryetarët e grupeve parlamentare e thanë fjalën e tyre. Të gjithë e thanë fjalën e vetë. “Vetëvendosja” e tha të vetën. Dhe, konsideroj që po hyjmë në procedurën e votimeve.

(Ndërhyrje)

Ju njoftoj se të gjitha grupet e kanë thënë fjalën e tyre dhe po hyjmë në procedurën e votimit. Ju njoftoj se duke u bazuar në nenin 144, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e 2/3-ve të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dhe 2/3-at e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve, që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës.

Do të thotë, këtë duhet ta kemi parasysh. Pra, nevojiten 80 vota, përfshirë këtu 14 vota të komuniteteve të tjera. Në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, votimi i amendamenteve do të bëhet në pako me një votim, përfshirë këtu propozimin e Komisionit për amendamentin 17, i cili do të bartet në kapitullin e dytë të Kushtetutës.

Para se të kalojmë në procedurën e votimit, kërkoj nga deputetët që me votim elektronik ta konfirmojnë praninë e tyre në mbledhje.

Edhe një herë, ju lutem për prani! Votojmë për praninë! 110 deputetë e kanë treguar praninë.

A ka pa kartelë? Nuk ka. Mirë! Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e amendamenteve në grup. Votojmë tash!

Konstatoj: Me 98 vota për, 10 kundër, 1 abstenim,... Ta presim regjinë të na e sjellë rezultatin e votimit të komuniteteve.

Do të thotë, jemi marrë vesh me grupet parlamentare, me kryetarët e tyre për procedurën që e udhëhoqëm dhe, ju lutem, votimi ka përfunduar. Unë po e drejtoj seancën. Jem marrë vesh me kryetarët e grupeve parlamentare, prandaj edhe u votua siç jemi marrë vesh. Me ty, nuk jam marrë vesh... Po dua të tregoj që me ty nuk jam marrë vesh, por me shumicën e grupeve parlamentare.

Faleminderit! Kanë votuar “për” gjithsej 98 deputetë, nga komunitetet në pakicë, “për” kanë votuar 22 veta. Kuvendi i miratoi amendamentet kushtetuese, që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. Të gjithë deputetët kanë rast t’i shfaqin pikëpamjet e tyre edhe tash.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që ta prezantojë këtë çështje.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kryeministër, anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni fillimisht që në emër të kryeministrit dhe Qeverisë t'i falënderoj të gjithë deputetët për votimin e amendamenteve kushtetuese dhe tanimë do të thosha që me votim kanë hyrë në fuqi në mënyrë automatike dhe që tani mund të konsiderohet që pavarësia e mbikëqyrur e Kosovës ka përfunduar.

Më lejoni, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të paraqes marrëveshjen e arritur nëpërmjet shkëmbimit të letrave nëpërmjet Presidentes së Republikës së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë për Punë të Jashtme dhe Siguri, zonjës Eshton. Për ta ratifikuar këtë marrëveshje e kemi përgatitur edhe ligjin përcjellës, të nderuar deputetë, që e keni para jush, përkatësisht Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e rendit dhe ligjit në Kosovë. Republika e Kosovës po përpiqet me fuqi që ta ndërtojë një shoqëri demokratike, përparimtare, të zhvilluar ekonomikisht, me vlera të larta shoqërore dhe me sundim të ligjit, që është një prej pikave sfiduese, por edhe qëllimeve tona të përbashkëta. Dhe, pikërisht për këtë, vite më parë e kemi ftuar Bashkimin Evropian për të ndihmuar në ndërtimin e institucioneve tona në sundimin e rendit dhe ligjit.

Sot, duke e njohur nevojën për bashkëpunim të mëtijshëm me BE-në, aspiratat tona për forcimin e mëtijshëm për sundimin e rendit dhe ligjit në Kosovë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka propozuar këtë shkëmbim letrash si modalitet për ta zgjatur mandatin e EULEX-it në Kosovë dhe për ta njohur atë me marrëveshje ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Siç e dini, Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Presidenten e Republikës së Kosovës dhe autorizimit të saj kushtetuese, ka negociuar me autoritetet e BE-së shumë hollësisht për përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje ndërmjet shkëmbimit të letrave. Më lejoni të ju njoftoj, të nderuar deputetë, që kohë pas kohe, me shkrim, e kemi njoftuar edhe kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, kryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotin Mustafa, atë të "Vetëvendosjes", nënkryetarin e AAK-së, po ashtu edhe të grupeve tjera parlamentare që janë në Kuvend, si dhe kryetarin e Komisionit për Çështje Legjislative dhe kryetarin e Komisionit për Integrim Evropian. Natyrisht, pas dërgimit të ftesës sonë për zgjatjen e mandatit të EULEX-it dhe kthimit të përgjigjes pozitive, e kemi pranuar këtë ftesë me përmbajtje të plotë, të cilat besoj që bëjnë pjesë edhe në këtë projektligj, por edhe janë pjesë e marrëveshjes sonë ndërkombëtare. Kemi punuar shumë në studimet e kërkesave ligjore të Kushtetutës sonë, në veçanti në kërkesat ligjore për delegimin e kompetencave, siç përmendet në ftesën e Presidentes, respektivisht sipas nenit 20 të Kushtetutës së Republikës sonë dhe më pas sipas neneve 19 dhe 18. Kjo që po e prezantojmë sot para jush, të nderuar deputetë, është

një marrëveshje që i plotëson të gjitha kriteret ligjore sipas së drejtës ndërkombëtare për ta konsideruar si marrëveshje ndërkombëtare dhe për më tepër i përmbush të gjitha kërkesat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Siç përshkruhet edhe në vetë ftesën e presidentes Jahjaga, sot ftoheni që në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ta ratifikoni këtë marrëveshje për të hyrë në fuqi si marrëveshje ndërkombëtare. Ligji përcjellës për hyrjen në fuqi sipas Rregullores dhe frymës së Kushtetutës sonë është një ligj jo i zakonshëm, duke qenë se pas ratifikimit tuaj, sipas nenit 18, me 2/3 e votave të deputetëve të Kuvendit, ligji miratohet qysh në leximin e parë. Prandaj, ju ftoj gjithashtu që të votoni për miratimin e këtij ligji.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'i theksoj disa çështje që përmban marrëveshja dhe qëllimi i këtij ligji, që të ratifikohet si marrëveshje në tërësi. Po i përmend disa:

- 1) Zgjatja e mandatit të EULEX-it në fushat e parapara në marrëveshje deri më 15 qershor të vitit 2014,
- 2) Delegimi i autoritetit për propozim dhe emërim të gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në përputhje me Kushtetutën, respektivisht neni 20 e autorizon Qeverinë për ta ndërtuar një sistem regjistrimi për armëmbajtjen e lejuar për stafin e EULEX-it,
- 3) Garantimi i imunitetit të stafit të zyrës dhe personelit të EULEX-it dhe përfaqësuesi special të BE-së në bazë të Ligjit për statusin dhe imunitetin dhe privilegjet e misionëve diplomatike konsullore dhe të personelit të tyre dhe pranisë ushtarake në Kosovë.

Më lejoni që t'i theksoj disa çështjet që mund të përmenden në këtë letër dhe natyrisht që duhet ta kuptojmë që është një marrëveshje që arrihet si pjesë e bisedimeve dhe e kompromisit të përbashkët me BE-në. Por, si të arritur mund të konsiderojmë: 1. Vendimmarrja për zgjatjen e mandatit të EULEX-it po vendoset për herë të parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, 2. Emërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it do të bëhet sipas procedurave dhe me plotësimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe pëlqimin nga Presidentja e Republikës së Kosovës, 3. Armëmbajtja e personelit të EULEX-it do të jetë e notifikuar me emër dhe mbiemër në një regjistër që do të koordinohet bashkërisht me Ministrinë e Punëve të Brendshme, 4. Është hera e parë që e kemi një letërkëmbim që mund ta arrijë shkallën e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës dhe atyre të BE-së dhe 5. Askund nuk përmendet Rezoluta 1244.

Para se ta përfundoj fjalën time, më lejoni që t'i falënderoj gjithë ata që kanë bashkëpunuar në këtë drejtim, të gjitha partitë politike, të cilat kanë marrë pjesë edhe gjatë debatit, edhe me përfaqësuesit vendorë dhe ndërkombëtarë. Më lejoni ta falënderojmë për punën e vet mandatin e EULEX-it në Kosovë dhe të kërkojmë një bashkëpunim më të ngushtë në dy vjetët e ardhshme, duke e përplotësuar një plan për transferimin e kompetencave nga institucionet e EULEX-it te ato të Kosovës, plan i prezantuar në Bruksel në fund të majit të këtij viti, por që u është shpërndarë edhe deputetëve, respektivisht kryetarit të Kuvendit, Komisionit për Legjislacion dhe atij për

Integrime Evropiane, dhe kryetarëve të grupeve parlamentare, apo të partive politike që janë në Kuvend.

Natyrisht, një rol të veçantë në negocimin e kësaj marrëveshjeje për muaj të tërë kanë luajtur përfaqësuesit vendorë të institucioneve, por do të thosha edhe përfaqësuesit e BE-së. Natyrisht, dua ta falënderoj kontributin e tyre që zoti Haber e ka bërë në emër të BE-së, por edhe zoti Zhblogar, Manrak dhe të tjerët, përfshirë edhe Ambasadën Amerikane. Por, në fund të fundit, është një marrëveshje që për herë të parë Republika e Kosovës po e bën dhe po ratifikohet në Kuvend. Unë dua të besoj që dy vjet më pas, Republika e Kosovës do t'i plotësojë kushtet për rendin dhe ligjin, dy vjet më pas Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ashtu sikur jep kompetencën për rendin dhe ligjin, dy vjet më pas konstatimi i BE-së do të jetë që Kosova i plotëson kushtet për rend dhe ligj dhe do të hapërojë sikur vendet e tjera dhe pastaj duhet të jemi vetëm në harmoni me Komisionin Evropian. Natyrisht, pres dhe ju ftoj për miratimin e kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare dhe, mbi të gjitha, pres që punët e ardhshme të jenë në proporcion të ngritjes së kapaciteteve tona dhe zvogëlimit të EULEX-it. Faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, deputeti Arben Gashi, në emër të komisionit.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Legjislacion, në cilësinë e Komisionit FunkSIONAL dhe Raportues, i ngarkuar nga Kryesia e Kuvendit, në pajtim me nenin 60 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 6 shtator 2012, e shqyrtoi Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë. Dhe, vlerësoi se Projektligji ka bazë për t'u proceduar për shqyrtim dhe për miratim në Kuvend. Mirëpo, para se të shqyrtohet dhe të procedohet duhet të kemi parasysh disa elemente, të cilat janë diskutuar dhe janë vërejtur në komision.

Komisioni ka vërejtur se në kuadër të kësaj duhet të ketë parasysh që të bëhet një shmangie e lehtë e Rregullores, ku thuhet se çdo ligj që kalon në Kuvendin e Kosovës duhet ta ketë deklaratën financiare, duhet t'i ketë shkresat përcjellëse të Qeverisë dhe duhet ta ketë deklaratën nga Komisioni për Integrime Evropiane nëse ky ligj i përshtatet aquí komunitare. Po ashtu, duhet të kemi parasysh se ky ligj, sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, aprovohet me një lexim, sepse aprovohet sipas nenit 60 të Rregullores së Punës dhe nuk ka nevojë për dy lexime. Prandaj, i rekomandoj seancës që t'i ketë parasysh këto vërejtje dhe mbi bazën e tyre të marrë vendim dhe ta aprovojë këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Është ligj i veçantë dhe, sipas Rregullores, nuk u nënshtrohet të gjitha komisioneve dhe nuk ka implikime buxhetore, dhe vlen neni 60, pika 3 e Rregullores.

Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kryetari Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar në takim të veçantë këtë marrëveshje. I kemi bërë gjithë analizat dhe i kemi marrë të gjitha informacionet rreth kësaj marrëveshjeje. Kemi ardhur në përfundim që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike në mënyrë unanime do ta votojë, do ta përkrahë këtë marrëveshje dhe i lutim të gjithë kolegët e tjerë që ta përkrahin dhe ta votojnë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike deputetja, fjalën e ka Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Lidhja Demokratike e Kosovës e përkrah krijimin e bazës juridike e kushtetuese për vazhdimin e mandatit të EULEX-it, në përputhje me procedurat e parapara në Kushtetutë.

Ratifikimi i projektligjit për këtë marrëveshje ndërkombëtare është edhe në përputhje me Konventën e Vjenës për traktate që parash shkëmbimin e instrumenteve, si një prej mjeteve për lidhje të një marrëveshjeje ndërkombëtare ndërmjet një shteti dhe një organizate ndërkombëtare. Ashtu siç e parasheh neni 20 i Kushtetutës, ky Kuvend është i vetmi institucion që mund të bëjë delegimin e kompetencave shtetërore te një institucion apo organizëm ndërkombëtar. LDK-ja konsideron se me sfidat e jashtëzakonshme në fushën e sundimit të ligjit, veçanërisht në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, Kosova ka ende nevojë për një prani evropiane që do t'i ndihmojë institucionet e Kosovës, veçanërisht Gjyqësorin për ngritjen e standardeve, efikasitetit dhe pavarësisë në punën e tyre. LDK-ja i bën thirrje EULEX-it që në këtë mandat, duke pasur parasysh sfidën kryesore në vend, shtrirjen e kontrollit në veri, t'i shumëfishojë përpjekjet për luftimin dhe shuarjen e strukturave kriminale në këtë pjesë të vendit. Po ashtu, i bëjmë thirrje EULEX-it që Task Forca për hetime speciale t'i përfundojë hetimet sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që po ashtu të përfundojë edhe rrënimin i imazhit të Kosovës në botë lidhur me ato pretendime.

Përfundimisht, Lidhja Demokratike e Kosovës i bën thirrje EULEX-it që t'i shumëfishojë përpjekjet që t'i denoncojë dhe t'i dënojë krimet dhe korrupsionin në qarqet e larta qeveritare. Prokuroria, qoftë e EULEX-it, qoftë e Kosovës, e ka për obligim që të merret ex officio me krimet që po pranohen në mënyrë publike. Ditëve të fundit, të gjithë jemi dëshmitarë të pranimin publik të krimeve, qoftë ndaj presidentit Rugova, qoftë krimeve të tjera që edhe EULEX-i i ka kualifikuar si vrasje të organizuara për motive politike. Lidhja Demokratike e Kosovës i bën thirrje EULEX-it që urgjentisht t'i iniciojë hetimet për këto krime, për këto raste, në përputhje me obligimet ex officio. Ne dëshirojmë rezultate konkrete, e jo vetëm deklarata. Lidhja Demokratike e Kosovës, prandaj, do ta përkrahë vazhdimin e mandatit të EULEX-it nëpërmjet ratifikimit të marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, fjalën e ka nënkryetari Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Ka disa ditë që Presidenca, në veçanti, dhe Qeveria janë vënë në siklet se si ta akomodojnë mandatin e EULEX-it dhe vazhdimin e këtij mandati deri në vitin 2014 në Republikën e Kosovës. Mendoj që ekzistojnë disa probleme me qasjen që e kanë aplikuar këta për t'i bërë thirrje një misioni që ta vazhdojë mandatin e vet në Kosovë, mision ky që, siç e dimë, në mënyrë të qartë është pozicionuar si neutral karshi sovranitetit tonë dhe pavarësisë së Republikës së Kosovës.

E para e punës, mua nuk më është dukur në rregull që pa një diskutim substancial në Kuvendin e Kosovës, Presidentja dhe Qeveria i kanë dërguar letër këtij misioni dhe ne tash jemi këtu në prag të miratimit, apo të mosmiratimit të një gjëje, për të cilën këta paraprakisht kanë vendosur. Mendoj që ky është një defekt i demokracisë në Kosovë. Shpresoj që kjo të mos ndodhë në të ardhmen, sepse është rendi që Kuvendi paraprakisht të debatojë nëse kemi nevojë apo jo për një mision të tillë; cilat kanë qenë rezultatet konkrete të punës së një misioni të tillë, e më pastaj, në bazë të indikacioneve, të debateve e diskutimeve që ndodhin në Kuvendin e Kosovës, ta marrin dritën jeshile, edhe Presidenca, edhe Qeveria, se si duhet të procedohet më tutje. Mendoj që kjo mënyrë se si po veprojmë është e gabueshme dhe është një defekt i demokracisë në Kosovë.

Tjetra, në letrën e Presidencës kam vërejtur disa mangësi dhe disa veprime, të cilat meritojnë kritikë. E para, Presidentja e falënderon shumë EULEX-in për stabilitet dhe prosperitet në Kosovë, e unë mendoj që EULEX-i i ka tri dështime shumë të mëdha në Kosovë. Dështimet e EULEX-it në Kosovë janë: lufta kundër korrupsionit, për të cilën pajtohemi të gjithë që ka qenë një dështim shumë i madh i EULEX-it; kanë qenë krimet e luftës, të cilave EULEX-i gjithmonë u është qasur në mënyrë etnike, pra vetëm krimet e luftës për të cilat është supozuar se i kanë bërë shqiptarët, ndërkohë që kriminelët e luftës fshihen në Serbi, që i kanë vlarë mbi 12 000 shqiptarë gjatë luftës së fundit të armatosur në Kosovë, e shumica prej tyre janë të lirë. UNMIK-u për asnjërin nuk ka bërë ndjekje penale, as në mungesë bile. Kjo është një qasje etnike ndaj krimeve të luftës dhe një dështim i madh i EULEX-it. Po ashtu, edhe strukturat e paligjshme të Serbisë nuk janë ndjekur fare, nuk janë prekur strukturat e paligjshme.

Ashtu siç e ka thënë edhe ambasadori amerikan dje në OSBE, strukturat e paligjshme janë arsyeja e vërtetë e destabilizimit të Kosovës. Kurse Presidentja po e falënderon EULEX-in se ka kontribuar shumë në stabilitetin e Kosovës. E nëse strukturat e paligjshme të Serbisë janë potenciali kryesor destabilizues, le të na tregojë EULEX-i stabilizues çfarë ka bërë kundër strukturave të paligjshme të Serbisë edhe në veri, por edhe në pjesët tjera. Unë po them: nuk ka bërë asgjë. Dhe, ky është një dështim i madh i EULEX-it, të cilin ne duhet ta përmendim patjetër.

Po ashtu, mendoj që deklarata e baroneshës Ketrin Eshton për bisedime të reja për veriun është e dëmshme në raport me ridimensionimin e misionit të EULEX-it për të ardhmen. Shtrohet pyetja, pse? Sepse, kur shefja e vërtetë e EULEX-it, se baronesha e Eshton është shefja e vërtetë e EULEX-it, se departamenti i Eshtonit e ka dërguar EULEX-in në Kosovë, atëherë ajo thotë që duhet të ketë negociata për atë pjesë, kjo automatikisht i jep

kuptim specifik angazhimit të EULEX-it në atë pjesë të Kosovës. Tash në atë pjesë të Kosovës do ta kemi një EULEX, i cili nuk do të pranojë kurrfarë përpjekjeje të autoriteteve të Prishtinës për ta shtrirë sovranitetin e Kosovës në atë pjesë. Pse? Sepse, për atë pjesë do të bisedohet. Ajo pjesë është pikëpyetje.

Kjo është shumë e dëmshme për misionin e ardhshëm të EULEX-it. Kjo deklaratë e Ketrin Eshtonit, ky qëndrim politik, për arsye se e bën EULEX-in të jetë mision, i cili në veri do të synojë me çdo kusht ta mbajë status quo-n. E, cila është status quo-ja? Status quo-ja është kontrolli konkret i situatës prej strukturave ilegale të Beogradit, të cilat Serbia i financon dhe i kontrollon.

Po ashtu, janë edhe disa probleme tjera në këtë mënyrë të qasjes. Unë nuk pajtohem po ashtu me mënyrën se si e arsyetoi zëvendëskryeministri referencën në nenin 20.1 të Kushtetutës. Për këtë nen ta kemi parasysh një gjë! Dorëzimi i sovranitetit, harmonizimi i sovranitetit ndodh në rastet kur shteti anëtarësohet në ndonjë organizatë ndërkombëtare. Për këtë bëhet muhabet këtu. Jo për një mision të Bashkimit Evropian, i cili vjen të na qeverisë, e ne ia dorëzojmë disa prej kompetencave. Kjo flet për marrëdhëniet ndërkombëtare, për shtetin si subjekt të marrëdhënieve ndërkombëtare. Kjo është në çdo kushtetutë të botës - dorëzimi i një pjese të sovranitetit, ama jo çdo shtet i botës ka EULEX. Asnjë shtet, i cili po aspiron për të hyrë në BE nuk ka pasur EULEX, nuk ia ka dorëzuar një pjesë të kompetencave një misioni të huaj për të qeverisur. Kroacia është në BE, por kurrë nuk ka pasur EULEX.

Do të thotë, e kam fjalën që kur Kosova anëtarësohet, ta zëmë, në Bashkimin Evropian natyrisht që duhet ta harmonizojë sovranitetin e vet, duhet ta dorëzojë një pjesë të sovranitetit të vet, që ta harmonizojë me BE-në. Mirëpo, ne pa qenë në BE fare, pa qenë të anëtarësuar, po ia dorëzojmë kompetencat në një fushë të caktuar të drejtësisë dhe gjyqësisë një misioni të Bashkimit Evropian në Kosovë, gjë që nuk më duket në rregull.

Presidentja, po ashtu, në të njëjtën fjali, thotë: “Kërkojmë që të vini në Kosovë dhe të veproni sipas ligjeve vendore”, kurse në të njëjtën fjali, pak më poshtë, thotë: “Ju jeni imunë ndaj ligjeve vendore”. Të veproni sipas ligjeve vendore dhe të jeni imunë ndaj po atyre ligjeve vendore. Kjo është vërtet shumë e çuditshme dhe shumë interesante.

Po ashtu, është thënë që misioni do të ketë mandat deri më 15 qershor 2014. Mirëpo, nëse e lexoni me vëmendje letrën e Presidentes, atëherë janë dy gjëra që duhet t'i vëmë në spikamë. Aty thuhet do të përfundojë më 15 qershor 2014, po citoj: “Nëse ekziston vlerësimi i përbashkët”. Domethënë nëse të gjithë faktorët ndërkombëtarë pajtohen, dhe nëse Qeveria jonë pajtohet dhe të gjithë ne pajtohemi, atëherë mandati i EULEX-it përfundon. Por, nëse veç dikush nuk pajtohet, mandati i EULEX-it vazhdon automatikisht.

Gjithashtu, Presidentja thotë që për ne është kohë e pritshme që të jetë 15 qershori 2014. Jo kohë e sigurt, por kohë e pritshme. Domethënë kemi qejf, kemi dëshirë, po mos u bëftë - e këqyrim edhe një herë.

Po ashtu, mendoj se është e gabueshme që në letrën e Presidentes kemi pasur një mandat që është i kufizuar përafërsisht më 15 qershor 2014, kurse zoti Kuçi, me letrën e vet dërguar baroneshës Eshton, thotë që për angazhime shtesë specifike të EULEX-it në pjesën veriore të Kosovës, sidomos sa i përket pjesës veriore dhe krimeve të luftës, mandati i EULEX-it të mos vazhdojë më vonë se 31 dhjetor i vitit 2015. Tash këtu disi po na krijohen dy EULEX-a, një EULEX i Presidentes dhe një EULEX i Qeverisë, me afate të ndryshme shtesë.

Edhe kjo mendoj se është joserioze dhe mendoj se, po ashtu, pse kemi pasur EULEX deri tash në Kosovë, arsyeja është shumë e qartë. Bashkimi Evropian ndoshta na ka konsideruar të papjekur për demokraci, ndoshta na ka konsideruar shumë të korruptuar dhe duhet vazhdimisht një mbikëqyrje për këta qeveritarët, mirëpo unë mendoj që kur të shkojë korrupsioni prej Kosovës do të shkojë edhe EULEX-i bashkë me të prej Kosovës.

KRYETARI: Në emër të Grupit të AAK-së, fjalën e ka kryetari Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Një prej kryefjalëve të punës dhe të dokumenteve të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës është sundimi i ligjit.

Por, ne mendojmë se sundimi i ligjit është, jo vetëm lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe nëse mund t'i kthehem pak, sundimi i ligjit është mundësia e studentëve të regjistrohen nëpër fakultete pa pasur nevojë ta njohin një ministër, ose një zyrtar të lartë të shtetit, ose një kryetar komune. Sundimi i ligjit është mundësia e qytetarëve të Kosovës të punësohen në bazë të meritës, dijes dhe të kualifikimit, pa pasur nevojë ta njohin një zyrtar të lartë të shtetit. Sundimi i ligjit është mundësia e të gjithë njerëzve të Kosovës të shërohen kur të kanë nevojë, pa pasur nevojë ta njohin një zyrtar të lartë të shtetit; të bëjnë biznes pa pasur nevojë të japin mitë, të jenë të barabartë dhe të mos detyrohen ta ulin kokën para të fortëve ose para pushtetarëve, por të jenë në gjendje t'iu dorëzuar vetëm ligjit, e jo individit; për të funksionuar demokracia e për të mos u vjedhur votat e tjera, e tjera.

Do të thotë, sundimi i ligjit janë të gjitha këto. Dhe, përderisa Kosova sot fatkeqësisht është ende larg për t'i arritur këto standarde, për të cilat fola, mendojmë se Kosova ka nevojë për mbështetje në sundimin e ligjit.

Aleanca do ta votojë Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për zgjatjen e mandatit të EULEX-it në Kosovë. Detyrimisht do të insistojmë që edhe puna e EULEX-it, por fillimisht puna e institucioneve të Kosovës në sundimin e ligjit të rritet, në mënyrë që të profetizohet fjala e fundit, të cilën e tha parafolësi: “Në Kosovë nuk do të ketë EULEX, kur nuk do të ketë korrupsion dhe krim të organizuar”. E kush do ta luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar? Mendoj se duhet të jemi ne të parët, mirëpo na bën shumë mirë prania e EULEX-it edhe për një kohë të caktuar, në mënyrë që t'i luftojmë këto dukuri.

Përfundimisht, do ta votojmë këtë ligj për ratifikimin e marrëveshjes dhe do të insistojmë që ky mandat i EULEX-it të jetë i tillë që të mos zgjatet më. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, fjalën e ka kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit kryetar!

Duke marrë parasysh se Koalicioni për Kosovë të Re e ka marrë projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë, mund të thuhet se Kosova është akoma shtet i ri dhe i duhet përkrahje në sundimin e ligjit, që do të thotë në luftimin kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, mirëpo Koalicioni për Kosovë të Re, duke marrë parasysh se edhe Komisioni për Legjislacion e ka dhënë dritën jeshile për këtë ratifikim të kësaj marrëveshjeje, e përkrah dhe shpreson e beson që EULEX-i deri në vitin 2014 do të jetë më fleksibil në punën e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit të SLS, fjalën e ka deputeti Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

Uvaženi članovi Vlade,

Kolege poslanici,

Samostalna Liberalna Stranka podržava ratifikaciju Međunarodnog sporazuma između Kosova i EU o misiji Evropske unije za vladavinu prava na Kosovu. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Në emër të “6+”, fjalën e ka deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna grupa “6+” razmotrila je Nacrt zakona o ratifikaciji Međunarodnog dogovora između Republike Kosova i Evropske zajednice o misiji Evropske zajednice za vladavinu zakona na Kosovu. Podržaće ovaj nacrt zakona i glasaće za njega. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe deputeti Muhamet Mustafa, në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, e ka fjalën!

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit zoti kryetar!

Unë nuk po flas në emër të Koalicionit. Natyrisht, po flas në emër të deputetit, edhe pse e përkrah qëndrimin e Koalicionit se ky ligj duhet të votohet.

Unë mendoj se institucionet e Kosovës sot po e bëjnë një hap më tutje në marrjen e përgjegjësi për ta qeverisur vetë Kosovën dhe ky është pa dyshim një rezultat i rëndësishëm. Është rezultat i rëndësishëm, sepse edhe me amendamente, edhe me këtë ligj, ne po e zvogëlojmë shkallën e ambiguitetit dhe dualitetit në qeverisjen e Kosovës lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat. Ky ambiguitet dhe ky dualitet në përgjegjësi dhe kompetenca të qeverisjes së Kosovës na ka përcjellë prej pranisë së UNMIK-ut e deri këtu dhe pa dyshim është një nga shkaqet që ka bërë që cilësia e qeverisjes në Kosovë edhe më tutje të mbetet e ulët.

Prej tash, Qeveria e Kosovës dhe institucionet e Kosovës mund të fshihen e arsyetohen shumë më pak prapa kompetencave të ICO-s ose kompetencave tjera që kanë kaluar në përgjegjësitë e tyre. E kjo është e rëndësishme. Këtë nuk duhet ta mohojmë.

Ne sot po e ratifikojmë këtë ligj, i cili ka rëndësi të madhe për një sektor shumë të rëndësishëm, që është pika kritike e sundimit të ligjit në Kosovë. Ne e dimë që sundimi i ligjit në Kosovë është ajo që duhet të jetë prioriteti numër një. Mirëpo, unë shoh nganjëherë pritje të tepruara nga EULEX-i dhe nënvlerësim të përgjegjësisë së këtij Kuvendi. Prandaj, pika nisëse për sundimin e ligjit në Kosovë është ky Kuvend. Dhe, ne sot duhet ta dimë që po marrim përgjegjësi shumë më të mëdha dhe duhet të sillemi me përgjegjësi shumë më të madhe. Mos të na ndodhë që të krijojmë mungesa artificiale e forume, kur duhet të vendoset. Mos të na ndodhë që raportimi i atyre që duhet t'i raportojnë këtij Kuvendi të jetë vetëm formal.

Prandaj, ne jemi pikënisja për sundimin e ligjit. Ne deputetët që i kemi marrë votat nga qytetarët e Kosovës.

Ne do ta luftojmë korrupsionin dhe do ta vendosim sundimin e ligjit vetëm kur ta krijojmë një masë kritike të vetëdijes dhe përgjegjësisë sonë. E, sa i përket EULEX-it, nëse i shohim këto katër vjet të pranisë së tij, sigurisht se nuk mund të jemi të kënaqur.

Ky Kuvend me plot vetëdije dhe dëshirë e përkrah edhe ftesën e Presidencës, edhe komunikimin e Qeverisë me EULEX-in, por ne kërkojmë edhe nga Qeveria, edhe nga ky vend, edhe nga Komisioni Evropian që të krijohet një vijë e qartë e raportimit dhe përgjegjësisë së EULEX-it këtu, sepse diferenca pozitive që e ka krijuar deri tash është e vogël. Ne presim që EULEX-i, me praninë e tij në këtë vend të krijojë diferencë më të madhe pozitive dhe ta krijojë atë diferencë në mënyrë që e fuqizon rolin e institucioneve të Kosovës. Dhe, vërtet nëse i krijojmë këto relacione, më 14 qershor 2015 ne do të konstatojmë, edhe EULEX-i, edhe Komisioni Evropian, edhe ky Kuvend, se prania e EULEX-it nuk është më e nevojshme.

Në këtë drejtim, duhet t'i vlerësojmë si një hap të rëndësishëm edhe amendamentet e Kushtetutës, edhe këtë ligj. Mendoj se kurrfarë triumfalizmi nuk duhet të ketë në mesin tonë, sidomos në Qeverinë e Kosovës, sepse nevoja për forcimin e Qeverisë dhe për sundimin e ligjit është imanente dhe ne duhet të jemi të vetëdijshëm. Po dëgjoj nga Qeveria dhe ne që flasin për hendekun e madh ndërmjet gjendjes në sundimin e ligjit, në zhvillim ekonomik e në çështje tjera dhe asaj që synojmë drejt përmbytjes së përgjegjësisë sonë ndaj qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, mendoj se duhet të jemi të vetëdijshëm që ne jemi ata që duhet ta krijojmë diferencën, se EULEX-i duhet ta bëjë një diferencë më të madhe në mbështetje të krijimit të kësaj difference, por nuk mund ta zëvendësojë përgjegjësinë tonë.

Në këtë drejtim, mendoj se ne sot duhet t'ua dërgojmë një mesazh qytetarëve të Kosovës se po marrim përgjegjësi të mëdha, se këto përgjegjësi janë shumë të rëndësishme dhe se ne do të duhet ta ndryshojmë edhe sjelljen, edhe punën tonë që këto përgjegjësi t'i

realizojmë. Në këtë drejtim, mendoj se është mirë që iu adresuam Kushtetutës së Kaçanikut, sepse ajo ka reflektuar një vetëdije dhe një masë kritike të popullit të Kosovës për ta refuzuar okupimin. Ne sot duhet ta reflektojmë të njëjtën vetëdije për ta vënë sundimin e ligjit.

Pra, urime të gjithëve, por jo triumfalizëm, jo vetëkënaqësi, por përgjegjësi më e madhe. Ju faleminderit!

KRYETARI: Të pranishëm janë 110 deputetë, kurse prania elektronike 111.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 97 vota për, 11 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë.

Mirupafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë